



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:259616

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05641645

P.nr.317/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurve H.Z dhe K.D, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), dhe të pandehurit A.M për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par. 2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1635/22 të datës 17.11.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **14.02.2024**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të dëmtuarit S.M të pandehurit H.Z se bashku me mbrojtësin e tij av. Valon Demiraj dhe të pandehurit K.D se bashku me mbrojtësen e tij av. Venera Gashi-Selmanaj, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 15.03.2024, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

- I -

Të pandehurit :

1. **H.Z** nga i ati S. dhe e ëma S., e gjinisë B., i lindur me datë ... në I., tani me vendbanim në fshatin V. Komuna I. i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
2. **K.D** nga i ati G. dhe e ëma M. e gjinisë H., i lindur me datë ... në I., tani me vendbanim në fshatin V. Komuna I., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

Me datë 06.06.2022, rreth orës 07:35, në Istog, në rr. "Zahir Pajaziti", me dashje e me qellim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, duke përdorë forcën marrin pasurinë e luajtshme pronë e të dëmtuarit S.M në atë mënyrë që *"i dëmtuari i len para banesës së tij dy biçikleta, të cilat kanë qenë të lidhura me dry, ku njëra ka qenë e lidhur për rrethojë, ndërsa tjetra ka qenë e bllokuar në rrotën e parë, aty shkojnë të pandehurit, të cilët e heqin me forcë drynin, i marrin biçikletat dhe largohen nga aty pa u vërejtur nga askush, e si pasojë e kësaj të dëmtuarit i shkaktojnë dëmin në vlerë prej 270 euro"*

- me çka kanë kryer veprën penale **vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 46, 48, 69, 70 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 369 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit Hashim Zenunaj dhe Kastriot Dreshaj i:

GJYKON

- I.** Të pandehurit **H.Z** i shqiptohet **dënimi më gjorbë** në shumën prej katërqind (400) euro dhe **dënimi me burgim** në kohëzgjatje prej një (1) viti, *të cilat dënime do të jenë të kushtëzuara, nuk do të ekzekutohen* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale.
- II.** Të pandehurit **K.D**, i shqiptohet **dënimi më gjorbë** në shumën prej katërqind (400) euro dhe **dënimi me burgim** në kohëzgjatje prej një (1) viti, *të cilat dënime do të jenë të kushtëzuara, nuk do të ekzekutohen* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale.
- III.** **Në të kundërtën**, nëse të pandehurit H.Z dhe K.D, brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryejnë veprë tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim dhe me gjorbë.
- IV.** **OBLIGOHEN** të pandehurit H.Z dhe K.D, secili veç e veç ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale, ashtu që, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumë nga **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajnë shumën nga **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- V.** **Pala e dëmtuar:** S.M, me vendbanim në rr. "Zahir Pajaziti" në Istog, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

- II -

Ndaj të pandehurit:

A.M nga i ati **Z.** dhe e ëma **H.** e gjinisë **Z.**, i lindur me datë ... ne **I.**, me vendbanim në fshatin **V.**, Komuna **I.**, i pa martuar, ka të kryer fakultetin, i punësuar, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të KPP-së, dhe neneve 14, 15, 17 te Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim:

- I. APROVOHET** marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me numër të lëndës në ndërmjetësim **ND.nr.56/2024 e datës 14.02.2024**, në mes të pandehurit **A.M.**, në njërën anë dhe palës së dëmtuar **S.M** në anën tjetër.
- II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1635/22 e datës 17.11.2022 dhe **PUSHOHET** procedura penale, sa i përket të pandehurit **A.M** i akuzuar për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par. 2 të KPRK-së.
 - *Për shkak se i pandehuri dhe i dëmtuari kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit sipas Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje është aprovuar zyrtarisht nga gjykata.*
- III.** Shpenzimet e procedurës penale, për këtë veprë penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1635/22 të datës 17.11.2022, kundër pandehurve **H.Z** dhe **K.D** për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe kundër të pandehurit **A.M** për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 14.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit **Ermal Demhasaj**, i dëmtuari **S.M** i pandehuri **H.Z** se bashku me mbrojtësin e tij av. **Valon Demiraj** i caktuar sipas detyrës zyrtare, i pandehuri **Kastriot Dreshaj** se bashku me mbrojtësen e tij av. **Venera Gashi-Selmanaj** e caktuar sipas detyrës zyrtare dhe i pandehuri **A.M**

Në fillim të kësaj seance, Gjykata i ka njoftuar të dëmtuarin **S.M** dhe të pandehurin **A.M**, se për veprën penale e cila i vihet në barrë të pandehurit **A.M** ligji ka paraparë edhe procedurën e

ndërmjetësimit sipas Ligjit për Ndërmjetësim, ku i dëmtuari dhe i pandehuri, janë pajtuar që kjo çështje penale sa i përket të pandehurit A.M të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, ndërsa prokurori i shtetit e ka kundërshtuar referimin në ndërmjetësim.

Gjykata pasi ka marrë mendimin e palëve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 2, 4, 8 dhe 12 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nenin 229 par.1 dhe 2 të KPP-së, me Vendimin e datës 14.02.2024, këtë çështje penale – vetëm sa i përket veprës penale e cila i vihet në barrë të pandehurit A.M e ka referuar në ndërmjetësim në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog.

Ndërsa, seanca e shqyrtimit fillestar ka vazhduar sa i përket të pandehurve H.Z dhe K.D, për veprën penale të lartcekur e cila ju vihet në barrë. Ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se të pandehurit H.Z dhe K.D., e kanë kuptuar akuzën, pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pas konsultimeve me mbrojtësit e tyre, ua ka mundësuar të pandehurve të deklarohen për pranimin e fajësisë apo të deklarohen të pafajshëm.

I pandehuri H.Z pas konsultimit me mbrojtësin e tij av. Valon Demiraj lidhur me fajësinë ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është përdur për këto veprime dhe i premtun gjykatës se ne te ardhmen do te këtë sjellje te mira dhe nuk do te kryej vepra penale.

I pandehuri K.D pas konsultimit me mbrojtësen e tij av. Venera Gashi-Selmanaj lidhur me fajësinë ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është përdur për këto veprime dhe i premtun gjykatës se ne te ardhmen do te këtë sjellje te mira dhe nuk do te kryej vepra penale.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurve H.Z dhe K.D, për veprën penale për të cilën akuzohen, një pranim i tillë u bë në mënyrë vullnetare dhe gjënë mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me rrethanat renduese apo lehtësuese për shqiptimin e dënimit tani nuk jam i gatshëm të deklarohem.

I dëmtuari S.M lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, ka deklaruar: se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, mirëpo pas pranimin të biçikletave nga ana e policisë të njëjtat kanë qenë të dëmtuara dhe me kanë kushtuar 65 euro që t'i riparoj.

Mbrojtësi i të pandehurit H.Z av. Valon Demiraj lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij ka deklaruar: se e mbështet pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, ky pranim i fajësisë vije si rezultat i konsultimit paraprak me të njëjtin, ku i njëjti është njoftuar për pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë dhe i njëjti pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë të vullnetshme, e ndjen veten fajtor për veprën që i vihet në barrë, andaj i propozoj gjykatës që këtë pranim fajësie ta

aprovj dhe i propozoj gjykatës që me rastin e vendosjes lidhur me vendimin mbi dënimin ndaj të mbrojturit tim të zbatohet rrethanat lehtësuese dhe në pajtueshmëri me ligjin dënimin eventualë të shqiptuar në burgim të ia zëvendësoj me ndonjë dënim të kushtëzuar.

Mbrojtësja e të pandehurit K.D av. Venera Gashi-Selmanaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj ka deklaruar: se e mbështet pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj, pasi që i njëjti është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtës, lidhur me pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, njëherit ky pranim gjënë mbështetje edhe në shkresat e lëndës, dhe të njëjtin pranim e ka bërë në mënyrë vullnetare, prandaj e lusim gjykatën që të pranojë pranimin e fajësisë për të mbrojturin tim e njëherit i propozoj që me rastin e marrjes së vendimit lidhur me shqiptimin e dënimit të këtyre parasysh që të gjitha rrethanat lehtësuese dhe të njëjtit t'i shqiptoj një dënim me të butë të paraparë me ligjin, eventualisht në rastin e vendosjes së shqiptimit të dënimit me burgim të njëjtin ta zëvendësoj me dënim të kushtëzuar.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, pas marrjes së mendimeve të lartcekura si dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim fajësie është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit e lartcekur për veprën penale të lartcekur për të cilën janë akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurit t'i shpall fajtor për veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe i ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se të njëjtit janë penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurve, po ashtu në veprimet e tyre manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga të pandehurit dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve ligjore, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që:

- për të pandehurin **H.Z** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur: se e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprën e kryer penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale, rrethanat personale se është i moshës së re, ndërsa **rrethana rëndues** nuk ka gjetur;

- për të pandehurin **K.D** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur: se e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprën e kryer penale, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryejnë vepra penale, rrethanat personale se është i moshës së re, ndërsa **rrethana rëndues** nuk ka gjetur;

Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal, të pandehurve iu shqiptoi dënimet e precizuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se këto dënime janë në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenin 69 të KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se këto dënime do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesit që të mos kryej vepra penale ne të ardhmen, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata, në kuptim të dispozitave të nenit 71 par.1 dhe nenit 72 të KPRK-së, e ne referim të gjitha rrethanave lehtësuese e sidomos pranimin e fajësisë dhe premtimit se ne te ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale, ndaj të pandehurve në këtë çështje penale ka aplikuar dispozitat për zbutje të dënimit me burgim nën kufirin e paraparë ligjor – minimum, për veprën penale e cila ju vihet në barrë, duke vlerësuar se edhe me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjithashtu gjykata nga rrethanat e lartcekura, vlerësoi se edhe dënimet e kushtëzuara me gjobë dhe burgim, të shqiptuara ndaj të pandehurve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesve sipas nenin 69 të KPRK-së, ngase edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 dhe 48 të KPRK-së, është që të mos zbatohet dënimi për vepra penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale. Ku me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me gjobë, kryesve iu tërhiqet vërejtja seriozisht dhe u bëhet me dije se nëse kryejnë vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore te verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 dhe nenit 452 par. 1 të KPP-së, i ngarkoi të pandehurit H.Z dhe K.D, secilin veç e veç me shpenzimet e procedurës, të precizuara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, e po ashtu konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i obligoi të paguajnë taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

PJESA -II- e aktgjykimit, sa i përket hudhjes së aktakuzës dhe pushimit të procedurës penale për të akuzuarin Adnan Mavraj

Gjykata me datë 14.02.2024, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog, është njoftuar me: Marrëveshjen për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar me numër Nd.nr.56/24 të datës 14.02.2024 (Shtojcën 3), sipas të cilës rezulton se ndërmjet palëve- këtu të akuzuarit A.M dhe të dëmtuarit S.M është arritur marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit. E cila marrëveshje pasi që është nënshkruar nga ndërmjetësuesi, është proceduar në gjykatë te gjyqtari i çështjes për aprovim.

Gjykata me vendimin e datës 26.02.2024 (shtojcën 5), e ka aprovuar marrëveshjen e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve – të akuzuarit A.M dhe të dëmtuarit Sali Metaj, konform nenit 15 te Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje është dokument i ekzekutueshëm.

Sipas nenit 248 par. 1, nën par. 1.4 të KPP-së, përcaktohet se Gjykata e hedhë aktakuzën dhe e pushon procedurën kur: “i akuzuari dhe i dëmtuari kanë lidhur marrëveshje ndërmjetësimi që është pranuar zyrtarisht nga gjykata”.

Gjykata pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale i akuzuari A.M dhe i dëmtuari S.M kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, duke vlerësuar se marrëveshja e lidhur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve është e paraparë dhe ne pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, si dhe pas aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës, e duke vepruar konform nenit të sipërcituar 248 par. 1, nënpar. 1.4 të KPP-së, u vendos që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale sa i përket të akuzuarit A.M, për veprën penale e cila i vëget në barrë, si në pjesën -II-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase nga arsyet e lartcekura vërtetohet se i akuzuari dhe i dëmtuari kanë lidhur marrëveshje ndërmjetësimi që është pranuar zyrtarisht nga gjykata.

Gjykata vendimin, lidhur me shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin A.M e ka marrë konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 248 par. 1, nën par. 1.4, 364, 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*